



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe të Rregullores QRK-Nr.17/2013 për Punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohen anëtarët e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, në këtë përbërje:
 - 1.1. Shpejtim Bulliqi, Universiteti i Prishtinës, kryesues;
 - 1.2. Zejnullah Gruda, Universiteti i Prishtinës, anëtar;
 - 1.3. Martin Berishaj, Universiteti i Lubjanës, anëtar;
 - 1.4. Hamit Basholli, Gjeodet, anëtar;
 - 1.5. Florim Isufi, Universiteti i Prishtinës, anëtar;
 - 1.6. Një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës;
 - 1.7. Një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës;
 - 1.8. Një përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës të Kosovës;
 - 1.9. Një përfaqësues i komunitetit, pa të drejtë vote (Riza Smakaj);
 - 1.10. Një përfaqësues i komunitetit, pa të drejtë vote (Zymer Neziri).
2. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Rregulloren QRK-Nr. 17/2013 për Punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Obligohen të gjitha institucionet kompetente që ta ndihmojnë Komisionin në kryerjen e detyrave të tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARAĐINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për nënshkrimin e Marrëveshjes Financare Trilaterale në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Shqipërisë për vitin 2016, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për nënshkrimin e Marrëveshjes Financare Trilaterale në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Malit të Zi për vitin 2016, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 44,550.00 (katërdhjetë e katërmijë e pesëqind e pesëdhjetë) euro për kompensimin e anëtarëve të Sekretarisë dhe të Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të Ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2016, shuma prej 19,350.00 (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë) euro dhe Janar-Dhjetor 2017, shuma prej 25,200.00 (njëzetepesë mijë e dyqind) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, nën kategoria e Rezervës me kod 38010 dhe barten në Ministrinë e Drejtësisë me kod 215, nën-programi "Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme" me kod 113 15, kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime", nën-kategoria ekonomike "Shpenzime të Ndryshme Intellektuale dhe Këshillëdhënëse" me kod 13 440.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/04

Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës të UÇK-së për ndarjen e mjeteve në shumë prej 478,876 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro për rregullimin e protezave të këmbëve, duarve, syve për invalidët e luftës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen si në vijim:
 - Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në shumë prej 200,000 euro dhe atë nga nën-programi 00300-Pensionet për Invalidët e Luftës, kategoria subvencione dhe transfere, nën kategoria ekonomike pagesa për invalidët e luftës me kod 22260 në shumë prej 150,000 euro dhe nga nën kategoria ekonomike subvencione për entitete jo publike me kod 21200 në shumë prej 50,000 euro;
 - Nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 në shumë prej 278, 876 euro dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi i Thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencionet dhe transferet, nën kategoria ekonomike subvencionet për entitetet jopublike me kod 21200.
 - Mjetet e lartcekura sipas këtij vendimi transferohen në xhirollogarinë e SHIL të UÇK-së 1110-003683-0001-63.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës të UÇK-së për ndarjen e mjeteve në shumë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro për rehabilitim në banjën e Kllokotit dhe në banjën e Pejës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 në shumë prej 50,000 euro dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi i Thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencionet dhe transferet, nën kategoria ekonomike subvencionet për entitetet jopublike me kod 21200. Këto mjete transferohen në xhirollogarinë e SHIL të UÇK-së 1110-003683-0001-63.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 356,300.00 (treqindpesëdhjetëegjashtëmijë e treqind) euro, Renovimi i shkollës "Musa Hoti" pas dëmtimeve nga zjarri në Komunën e Mitrovicës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod (232-11300), kategoria e shpenzimeve kapitale, nën kategoria ekonomike me kod (31110) dhe transferohen në Komunën e Mitrovicës me kod 642, në kategorinë e shpenzimeve kapitale, linja buxhetore 10/642/92110/31121/Projekt i Ri/0980 - Renovimi i shkollës "Musa Hoti" - Mitrovicë.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumën prej 200,000 euro (dyqind mijë euro), për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik - Ngrohtoren e Gjakovës, për sigurimin e mazutit për sezonin dimëror 2017-2018.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik kodi organizativ 213, nën-programi Ngrohja Qendrore, me kod 22400, kategoria e shpenzimeve, subvencione dhe transfere, nën kategoria subvencione për entitete publike me kod 21110.
3. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Organizatave joqeveritare të autorizuara nga MPMS-ja për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 200,000 euro për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare në Kosovë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010.
3. Mjetet nga pika 1. transferohen në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nën-programi 00300-Pensionet për Invalidët e Luftës, kategoria subvencione dhe transfere, nënkategoria 21200-Subvencione për entitete jopublike.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë që për shkak të mungesës së produkteve medicinale, të krijuar si pasojë e heqjes nga përdorimi të gazrave medicinale të paautorizuara, të procedojë menjëherë sipas Ligjit nr. 04/L-190 për Produkte dhe Paisje Medicinale, neni 39, për të tejkaluar gjendjen e krijuar.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/04
Datë: 22.09.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 39 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, të nenit 53 dhe 56 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për anulimin vendimit përfundimtar nr.10/50 datë 23.09.2015

1. Anulohet Vendimi Përfundimtar Nr. 10/50 datë 23.09.2015 për interes publik i pronave paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Qendrës Turistike Brezovica, Zonat Kadastrale Vërbeshitica, Berofc II, Jazhincë, Gotovusha dhe Shtërpcë të Komunës së Shtërpcës, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës Nr. 30 datë 25 Shtator 2015 sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgonë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Financave.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë